



HIDROCENTRALI BOSHKOV MOST

REZYME JO-TEKNIKE



Përgatitur nga : **GEING** KuK 

Prill, 2011

Lista e shkurtesave

CO ₂ ekuivalent -	Masë me të cilën përshkruhet se sa ngrohja globale mund të shkaktojë lloj të caktuar dhe sasi të gazrave të qelqta, duke përdorur sasi funksionale ekuivalente ose përqendrim e dioksidit të karbonit (CO ₂) si vlerë referuese.
Efektet kumulative -	Ndryshimi i përgjithshëm i mjedisit jetësor që mund të rezultojë nga një numër i ndryshimeve të vogla të cilat shkaktohen nga njeriu.
Oksigjen i tretur (OK) -	Masa për sasinë e oksigjenit që tretet ose pëmbahet në një mjedis të caktuar, në këtë rast akumulimi i ujit
BERZH –	Banka Europiane për Rikonstruksionim dhe Zhvillim
VNMJ -	Vlerësimi i Ndikimit ndaj Mjedisit Jetësor
ELEM -	SHA TERMOCENTRALET E MAQEDONISË (Kompani e pronës shtetërore që merret me prodhimin e energjisë elektrike.)
Erozioni –	Procesi i zbarkimit dhe transferimit të materive të ngurta (sedimenteve, tokës, shkëmbinjëve dhe materieve tjera të ngurta) nga burimi i tyre në një vend tjetër.
PESA -	Plani Ekologjik-Social Aksional
VNMJAS –	Vlerësimi i Ndikimit ndaj Mjedisit Jetësor dhe Aspekteve Sociale
UE -	Unioni European
Orë e gigavatit -	Njësia e energjisë elektrike e barabartë me 10,000,000,000 vat në orë
Gazrat e Qelqta (GHG) -	Gazi në atmosferë që e apsorbon dhe e lëshon rrezatim në vëllimin e nxehtë të rrezeve infra të kuqe
Uji nëntokësor -	Uji që gjindet nën tokën e shtresave të shkëmbinjëve depërtues ose tokës
Kanali përcjellës –	Kanali që e transporton ujin nga rezervuari/turbina e ujit te tubacioni nën presion (porta e ujit)
QHE –	Qendra Hidro-elektrike
Intervenim –	Ndërtimi për marrjen e ujit nga lumi që mund të përdoret për prodhimin e energjisë
KVA –	Kilovolt – Amper njësia që përdoret për forcat në qarkun elektrik
LACF –	Kuadri për kompenzimin e tokës dhe kompenzimin për të njejtën
MEPSO –	Operatori për transmetimin e energjisë elektrike në Republikën e Maqedonisë
Sasia minimale biologjike e ujit në lumin e domozdoshëm për mbijetesën normale të biodiversitetit të ujit	
проток	
MWe –	Megavat energjia elektrike
RJT –	Rezyme Jo-Teknike

Prodhimi gjatë	Prodhimi i energjisë elektrike vetëm atëherë kur ka një shpenzim të madhë me të cilin balansohet furnizimi me energji
Porta e ujit -	Porta ose ndërtimi për marrjen e ujit që e kontrollon rrjedhën e ujit ose gypin e mbyllur i cili e furnizon ujin për turbinat hidraulike
Tubacioni nën shtypjen e -	Energjia e brendshme e fluidit si rezultat i shtypjes që kryhet në enën, e HC Boshkov Most me ndryshimin e lartësisë së ndërhyrjes deri te turbina.
BRE -	Burimet e Ripërtitura të Energjisë
Sedimentacioni -	Tendencioni i thërmimeve të ngurta ta lëshojnë lëngun në të cilin gjinden dhe të shtresohen në pengesat.
PAPI –	Plani për Angazhimin e Palëve të Interesuara
Sifoni -	Rrjedha e lëngjeve nëpër gypa, në formë të kthyer të simbolit U, që e mundëson rrjedhën e ujit përpjetë pa ndihmën e pompave, me anë të ndihmës të forcës së rënies së ujit nëpër gypin e rrugës së gravitacionit, dhe lëshohet në nivelin më të ulët nga sipërfaqja e marrjeve
Shtresimi dhe shkëmbimi	Shtresimi është kur uji i liqenit ka shtresa me temperatura të ndryshme ose karakteristika tjera. Shtresat zhduken atëherë kur uji përziehet gjatë shkëmbimeve kohore.
Baseni i mbledhur (rezervuari) -	Rezervuar për skladimin e skajit të fundit nga akuadukti i mbyllur ose gypi i ujit për apsorbimin e rritjes së papritur të shtypjes, si dhe sigurimin e shpejtë të sasisë shtesë të ujit gjatë rrugës ma afat të shkurtër të shtypjes

1 Hyrje

SHA TERMOCENTRALET E MAQEDONISË (“ELEM”) Kompani e pronës shtetërore që merret me prodhimin e energjisë elektrike, propozon që të merret me ndërtimin dhe menaxhimin e objektit të hidrocentralit Boshkov Most. Objekti do të lokohet në 123 kilometra në perendim të Shkupit, në lumin Malla Reka, në pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë (figura 1, në të majt), në afërsi të qytetit të Dibrës, në teritorrin e komunave Dibër dhe Mavrovë-Rostushë. Lumi Malla Reka e formon kufirin jug-perëndimor të Parkut nacional “Mavrovë”, ndësa një pjesë e madhe e projektit do të lokohet në kufijt e Parkut.




Figura 1. Lokacioni i projektit në Maqedoni dhe në PN Mavrovë

ELEM-i e ka përgatitur Vlerësimin e Ndikimit ndaj Mjedisit Jetësor dhe Aspekteve Sociale (VNMJAS) me qëllim që të vlerësohen ndikimet potenciale të projektit nga njerëzit dhe mjedisi jetësor. Kjo Rezime Jo-Teknike (RJT) i tregon rezultatet kryesore të VNMJAS. Është një pjesë nga dokumentimi voluminoz, që e përfshin Studimin e VNMJAS, Planin për Angazhimin e Palëve të Interesuara (PAPI), Kuadri për kompenzimin e tokës dhe kompenzimin për të njëjtën (KKTK) dhe Planin Ekologjik-Social Aksional (PESA).

Të gjitha këto dokumente janë në dispozicion për shqyrtim dhe për komente në vendet në vijim:

- Selinë e ELEM-it në Shkup (SHA TERMOCENTRALET E MAQEDONISË (ELEM), 11 tetori nr. 9, 1000 Shkup, Maqedoni);
- Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (Zyra për Komunikim me Publikun, Drejtorin e Mjedisit Jetësor, Departamentin për Vlerësimin e Ndikimit të Projekteve ndaj Mjedisit Jetësor, Bul. Goce Dellçev pn (RTVM, kati i 10-11-12) 1000 Shkup, Maqedoni);
- Zyrtat e komunave Mavrovë dhe Rostushë (254, Rostushë Maqedoni) dhe Dibër (8 Shtatori 72, 1250 Dibër, Maqedoni);
- Parkun Nacional Mavrovë (Mavrovi Anovi, Maqedoni)

- Banka Europiane për Rikonstruksionim dhe Zhvillim (BERZH), zyra rezidente në Shkup (Qendra Soravia Shkup, kati i 7, Vasill Axhillarski p.n. 1000 Shkup)
- Selia e BERZH-it (One Exchange Square, London EC2A 2JN, United Kingdom).

Raport i plotë i VNMJAS (Vlerësimi i Ndikimit ndaj Mjedisit Jetësor dhe Aspekteve Sociale) është në dispozicion në veb faqet zyrtare të ELEM-t (www.elem.com.mk) dhe Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (www.moepp.gov.mk). Verzionet elektronike të Rezymeve Jo-Teknike, Planit për angazhimin e palëve të interesuara (PAPI), Planit për kompenzimin e tokës (KKTK) dhe Planit Ekologjik-Social Aksional (PESA) (në gjuhën angleze dhe maqedone, ndërsa PAPI dhe RJT në gjuhën shqipe) janë në dispozicion në veb faqen zyrtare të ELEM-it (www.elem.com.mk) dhe Bankës Europiane për Rikonstruksionim dhe Zhvillim (www.ebrd.com).

Secili mund të paraqesë komente për Studimin me VNMJ dhe për projektin. Periudha për debat publik dhe komente në Maqedoni do të zgjasë 30 ditë, duke filluar nga data e shpalljes publike. Periudha për debatin publik dhe për komentet e BERZH do të zgjasë 120 ditë, duke filluar nga data e shpalljes publike. Komentet mund të dorëzohen nëpërmes postës te ELEM-i ose te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, në adresat e lartpërmendura ose të dorëzohen përmes postës elektronike te ELEM-i, në boskov.most@elem.com.mk. Gjithashtu, janë paraparë debate publike në Shkup, Dibër dhe në Mavrovë-Rostushë, që Ministria dhe ELEM-i do ti prezentojnë informatat dhe do të marrën komente për VNMJAS. Data dhe koha e këtyra takimeve do të shpallet nëpër gazetatat dhe do të theksohet me kumtesë në tabelat e shpalljeve.

2. Pse është i nevojshëm projekti?

Ndërtimi i HC “Boshkov Most” do ta përmirësojë furnizimin me energjinë elektrike në Republikën e Maqedonisë, ndërsa kjo do të arrihet pa krijimin e emisioneve të rëndësishme të gazrave të qelqta.

HC „Boshkov Most “ do ta rrit pjesëmarrjen e burimeve të ripërtitura të energjisë në sistemin e prodhimit të energjisë në vend. Që ti arrijë qëllimet e dorëzuara nga Unioni Europian, Maqedonia duhet që ta rritë pejsazhin e burimeve të ripërtitura më së paku 21% të energjisë elektrike gjithpërfshirëse. Strategjia nacionale për zhvillimin energjetik 2010 (*Ministria e Ekonomisë, 2010*) vijnë në përfundim se Maqedonia duhet të ndërtojë një numër plotësues të hidrocentraleve, duke e përfshirë edhe HC “Boshkov Most”. Në këtë strategji të energjetikës dhe në strategjitë tjera, është përfshirë ndërtimi i HC “Boshkov Most” deri në vitin 2020, pa përjashtime ose vonesa të parapara.

3. Korniza ligjore dhe administrative

Procesi i vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit jetësor dhe aspekteve sociale ka për qëllim që të shërbejë si një bazë fillestare për sjelljen e vendimeve nga qeveritë kompetente të Maqedonisë, që janë të detyrueshëm ta përmirësojnë projektin para se të ndërtohet dhe të

lëshohet në përdorim dhe nga Banka Europiane për Rikonstruksionim dhe Zhvillim (BERZH, e cila e shqyrton mundësin për sigurimin e mbështetjes financiare të projektit.

Korniza e Maqedonisë

Ligji i mjedisit jetësor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 53/05,81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, dhe 124/10) e parashikon përpunimin e Vlerësimit të Ndikimit ndaj Mjedisit Jetësor (VNMJ) për projektet e caktuara. HC „Boshkov Most“ bën pjesë në kategorinë që përfshihet në Aneksin 1, pika 12 - Projektet hidroteknike (Gazeta Zyrtare e RM nr.74/05).

Studimi për VNMJ duhet të vërtetojë dhe përshkruaj se në çfarë mënyrëe projekti do të ndikojë negativisht ose pozitivisht, në burimet e mjedisit jetësor –cilësisë së ujit, kafshëve, peshqive, bimëve etj dhe njerëzve - situatës ekonomike, zhurmës, komunikacionit etj. VNMJ detyrimisht zbatohet nga ekspertët e autorizuar në pajtueshmëri me metodologjinë e vendosur, strukturën e lajmërimeve dhe dokumenteve të nevojshme. Gjatë gjithë procesit pjesëmarrja është e obligueshme.

Korniza e BERZH

Me Urdhërin e BERZH kërkohet që aktivitetet e saja të jenë ekologjikisht të shëndosha dhe ta promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm. Që të sigurohet plotësimi i këtij standardi të projekteve, Politika e BERZH-it për mjedisin jetësor dhe për çështjet sociale nga viti 2008, e cila përfshin 10 kushte, kërkon që të gjitha projektet të cilat i ka finacuar Banka ti plotësojnë standardet e Unionit Europian dhe praktikrat më të mira ndërkombëtare. BERZH e klason HC “Boshkov Most” në Kategorinë A (më të lartë), për të cilën kërkohet një Vlerësim i tërësishëm i ndikimit ndaj mjedisit jetësor.

4. Qëllimi dhe vëllimi i VNMJAS

Kryesisht, qëllimi i VNMJAS është të sigurojë që aktivitetet e ardhshme në lidhje me këtë projekt (p.sh projektimi, ndërtimi dhe puna e HC “Boshkov Most”) të përfundohen në një mënyrëe ekologjike, sociale dhe të pranueshme, në pajtueshmëri me rregullativën ligjore të Maqedonisë, si dhe me kushtet e BERZH dhe praktikrat më të mira ndërkombëtare. Sipas kësaj, elementet përfundimtare që përfshihen me VNMJAS ishin:

- Të inicohet procesi i konsultimit me personat potencial të interesuar dhe palët relevante të interesuara që të njejtit të informohen për projektin dhe të identifikohen problemet e tyre;
- Të identifikohen problemet ekologjike dhe socio-ekonomike;
- Të përshkruhen gjendja e tashme e mjedisit jetësor dhe kushtet socio-ekonomike;
- Të vlerësohen ndikimet potenciale (pozitive dhe negative) të projektit;
- Të përgatitet një plan dhe praktikë pune me të cilat do të mënjanohej, ose kompenzohen ndikimet e rëndësishme ekologjike dhe sociale;

- Të përgatiten programe për monitorim që të vërtetohet se projekti ndërtohet dhe punon ashtu siç është parashikuar dhe të identifikohen ndryshimet e kontrolleve ekologjike që mund të paraqiten si të nevojshme.

5. Alternativat e shqyrtuara

Projekti i propozuar është përshkruar në pjesën e 5 më poshtë. Qysh nga planifikimi i parë i projektit më 1980, u shqyrtuan një numër i caktuar i alternativave të ndryshme, duke përfshirë:

- Me dhe pa pendë dhe akumulim.
- Lokacione të ndryshme për pendën dhe akumulimin.
- Lloje të ndryshme, lartësi, dhe vendosje të ndryshme të objekteve shoqërore.
- Trase të ndryshme, lloje dhe dimensione të tunelit të ujit nga penda te porta e ujit dhe lokacionet e ndryshme të sistemit për grumbullimin e ujit.
- Sistemi për grumbullimin e ujit në anën jugore të lumit Malla Reka.
- Lokacionet e ndryshme të portës së ujit dhe objekteve shoqërore dhe lidhjes së portës së ujit me rrjetin elektrik.

6. Përshkrimi i projektit

HC “Boshkov Most” do të prodhojë 70 megavat energji elektrike, rreth 126 Gigavat në orë në vit, me shfrytëzimin e ujit nga lumi Malla Reka dhe rrjedhat e saja. Siç mund të vërehet në figurat 2 dhe 3, HC “Boshkov Most” ka shumë pjesë që janë gjërësisht të zgjeruara. Do të ndërtohet pendë me gjatësi prej 33 metra, në grykën e malit të ngushtë rreth një kilometri të fshatrave Tresonçë dhe Sellcë, të lumit Malla Reka, drejtpërdrejtë në vendin ku bashkohen lumëjt Jadovska Reka dhe Tresoneçka Reka. Do të mbledhet dhe ujë nga rrjedhat lokale të lumit Malla Reka, në lokacionet e fshatrave Tresonçë, Sellcë, Rosokë, Llazaropollë, Mogorçë, Osoj dhe Garë. Uji i rrjedhave do të transponohet në tuneli dhe rezervaret në akuaduktet dhe sifonet.

Akumulimi do të përfshijë rreth 22 hektarë, prej të cilëve 15 hektarë tani përdoren si kullosa, ndërsa sipërfaqja tjetër është pyllëzuar. Tuneli i ujit do të gërmohet në kodrën e anës së majtë të lumit Malla Reka dhe do të jetë me gjatësi prej 8,7 kilometra deri te baseni mbledhës. Nga baseni, uji do të rrjedh edhe 0,85 kilometra nëpër gypat e gërmuara, te poshtë drejt ndërtesës së makinerisë, e cila gjindet 365 metra më ulët nga akumulimi dhe është lokuar në anën e majtë të lumit Malla Reka, i drejtpërdrejtë para derdhjes së sajë në lumin Radikë. Centrali do të punojë 5 orë në ditë. Nga momenti kur do të kalojë nëpër turbinat për prodhimin e energjisë elektrike, uji do të kthehet në lumin Malla Reka rreth 200 metra në rrjedhën e sipërme nga vendi i bashkimit të tyre me lumin Radikë. Në vendin ku kanali lëshues lëshohet në lumin Malla Reka, do të ketë ndërtim të mbështetjes së betonit të bregut të pellgut, ndërsa pjesa e lumit më poshtë do të gërmohet dhe kontrolllohet. Përpos sajë me ndihmën e trafostacionit dhe largëpërçuesit prej 110kV, ndërtesa e makinerisë do të lidhet

me rrjetin nacional. Traseja sipas të cilës do të kryhet kjo lidhje me rrjetin ende nuk është përcaktuar në mënyrë precize. Nga momenti kur do të sillet vendimi, do të përcaktohet nëse do të ketë nevojë për një vlerësim të caktuar të vlerësimit të ndikimit për linjën transferuese.

Projekti, gjithashtu, do të përfshijë punë më të mëdha në lidhje me rrugët, duke përfshirë:

- Rikonstruksionin dhe zgjerimin e 7,5 kilometrave në rrugën ekzistuese për fshatin Tresonçë, nga udhëkryqi Gari-Tresonçë deri në Tresonçë. Koj do të përfshijë edhe mbindërtimin e të dy urave ekzistuese të lumëenjëve Tresoneçkë dhe Garskë dhe ndërtimin e tri urave të reja.
- Rikonstruksionin dhe zgjerimin (për 4.4 metra) të 985 metra të rrugës ekzistuese nga udhëkryqi Rosokë-Trestitonçë te fshatit Rosokë, duke përfshirë dy ura të reja.
- Ndërtimi i rrugës së re nga fshati Rosokë në gjersi prej 4,2 kilometrash, me një pjesë të shkurtë te sifoni.
- Ndërtimi i rrugës së re në gjersi prej 3,7 kilometrash nga objekti i ndërtimit pranë sifonit në Tresonçë deri te baseni mbledhës (3,7 kilometra), përsëri me një pjesë të shkurtër.
- zhvendosja e rrugës aktuale në fshatin Tresonçë – Diga Tresonçë, në një gjatësi 1,8 km
- dislokimi i seksionit të rrugës ekzistuese në fshatin Sellcë, në një gjatësi 400 m.






Figura 3. Në këtë figurë tregohen pjesët e HC “Boshkov Most” që lokohen në PN “Mavrovë”(sferat e kuqe)

- Ndërtimi i rrugës së re në gjerësi prej 0,7 kilometra nga fshati Rosokë deri te ndërhyrja e lumit Rosočkë.

Të dy rrugët e rikonstruara do të zgjerohen për 4,4 metra me një gjerësi të re prej 7.9 metra. Rrugët e reja do të jenë me 3 metra gjerësi dhe 44 centimetra të trashësi (30 zhavor cm, 10 cm univerzal dhe 4 cm asfalt betoni). Punimet rrugore janë paraqitur në figurën 4.




Figura 4. Rrugët që do të ndërtohen apo rindërtohen

Ndërtimi i HC „Boshkov Most“ do të zgjasë katër vite, ndërsa punët do të kryhen gjatë tetë muajve të vitit, nga marsi deri në tetor. Do të angazhohen në përgjithësi 885 punëtorë në ndërtimtari, në periudha të ndryshme. Në Tabelën 1 është treguar numri i përafërt i punëtorëve të cilët do të jenë të nevojshëm për çdo puntori, numri i ndërrimeve në një ditë dhe numri i muajve të nevojshëm për ndërtim. Punëtorët do të jetojnë në një kamp në afërsi të qendrës së lokacionit të projektit, në afërsi të bashkimit të lumëenjve Garskë dhe lumit Malla Reka.

Tabela 1. Të dhënat vlerësuese për ndërtimtaritë: ndrime, muaj dhe puntorë

	<i>Penda</i>	<i>Ndërtimet dalëse të pendës</i>	<i>Kanalet ujëore</i>	<i>Tuneli ujëorë</i>	<i>Ndërtesa e makinerisë</i>	<i>Rrugët</i>
Ndrimi në ditën e	2	3	1	4	2	2
Numri i muajve	19	15	23	41	12	i panjohur
Punëtorët	139	78	42	501	61	65

Sipas vlerësimeve, ndërtimi i projektit do të kërkojë 125 345 metra kub beton, 212142 metra kub material guri, 22774 metra kub argjil dhe 12,192 metra kub material filtrues dhe sasi shumë të vogla material tjetër (dru, çelik etj.). Argjila do të merret nga fshati Gorencë, material aluvial nga shtrati i lumit, ku do të ndërtohet penda, gëlqerishtë në afërsi të pendës dhe gur nga tuneli i ri i ujit.

Çimentoja për ndërtimtarinë do të bartet 140 kilometra nga fabrika e çimentos "Usje" nga Shkupi, ndërsa do të ketë tri makina për çimento në ndërtimtaritë.

7. NDIKIMET DHE MASAT PËR ZBUTJEN

Kjo pjesë i përshkruan ndikimet potenciale mbi resurset në mjedis dhe mbi njerëzit, të cilat mund të shkaktojnë projekti dhe përshkruan një numër të madh të aktiviteteve që do të ndërmerren që të parandalohen, zvogëlohen, ose kontrollohen këto ndikime potenciale.

a. Ndikimet potenciale ndaj cilësisë së ajrit

Në fazën e ndërtimit priten përkeqësime lokale në cilësinë e ajrit në kuadër të lokalitetit të drejtpërdrejtë në fushën e projektit.

Një numër i madh i aktiviteteve ndërtimore mund të gjenerojnë pluhur gjatë periudhave të thata, duke përfshirë edhe lëvizjen e automjeteve dhe pajisjeve në rrugë të paasfaltuara, grumbullimin dhe shfrytëzimin e dheut dhe materialeve ndërtimore, rrënimin, pastrimin e vegjitacionit, thërmimin e gurit dhe përzierjen e betonit. Në periudhat e thata kur pluhuri është i dukshëm do të duhet të ndërmerren masa për kontrollin e pluhurit, duke përfshirë edhe lagjen e rrugëve dhe ndërtimtarive. Përveç kësaj, automjetet dhe pajisjet që djegin karburante do të lirojnë emisione të mëdha, por mirëmbajtja e motorëve do ti reduktojë ato në minimum. Gjatë punës, do të ketë sasi të vogla të emisioneve të pluhurit nga komunikacioni në rrugët e paasfaltuara. Krahas

kësaj, mund të paraqitet një erë e pakëndshme nga kalbja e vegjetacionit kur akumulimi do të mbushet për herë të parë. Për këtë arsye, vegjetacioni do të tërhiqet para se të mbyllet penda.

Në përgjithësi, nuk duhet të ketë ndikime të rëndësishme në cilësinë e ajrit gjatë ndërtimit ose punimit, ndërsa ndikimet më të vogla duhet të jenë lokale dhe afatshkurtëra.

Rezime e masave për zbutje: kontrolli i pluhurit sipas nevojave, mirëmbajtja e motorëve, pastrimi i vegjetacionit para mbushjes së akumulacionit (nevojitet plan për pastrimin e vegjetacionit) dhe uljen në minimum të kilometrave të kaluar (nevojitet plan për menaxhimin me komunikacionin).

b. Ndikimet potenciale ndaj klimës

Djegia e karburanteve në automjete dhe pajisje do të lëshojë gazra të qelqta. Krahas kësaj, edhe kalbja e vegjetacionit, në akumulim do të lëshonte gazra të qelqta. Por, prodhimi i energjisë elektrike nga forca e ujit në vend të djegies së thëngjillit do ti zvogëlojë emisionet e gazrave të qelqta rreth 107,000 tonë në vit. Në përgjithësi, projekti nuk do të ndikojë në ndryshimet klimatike.

Rezime e masave për zbutje: mirëmbajtja e motorëve për zvogëlimin e emisioneve, pastrimi i vegjetacionit para mbushjes së akumulimit.

c. Ndikimet potenciale ndaj zhurmës dhe vibracioneve

Zhurma mund të jetë shqetësuese për njerëzi, posaçërisht për pjesët rurale, siç është kjo, ku ka nivel të ulët të zhurmës themelore dhe është shumë më shqetësuese gjatë natës.

Aktivitetet ndërtimore do të shkaktojnë rritjen e zhurmës në ambinet, andaj do të duhet që me kujdes të përcillet dhe kontrollohet. Aktivitetet primare që do të shkaktojnë nivel më të lartë të zhurmës janë kamionët dhe pajisjet, zhurma nga puna e pajisjeve dhe automjeteve në ndërtimtari (sidomos në pendë dhe në ndërtesën së makinerisë), rrënimi gjatë gërmimeve të tunelit, gërmimi i gurit dhe përzierja e betonit. Si burim më i madh i vibracioneve në fushën e projekteve do të jetë rrënimi gjatë gërmimeve në tunel dhe gërmimi i gurit. Penda ndodhet rreth 1 km nga fshati më i afërt. Ashtu që nuk do të duhet të ketë ndikim shqetësues te njerëzit, ndërsa në afërsi të ndërtesës së makinerisë nuk ka popullsi. Përveç gërmimeve të tunelit, puna do të kryhet në dy ndërrime, duke mos punuar në orët e natës. Edhe pse gërmimi në tunel do të zhvillohet 24 orë në ditë, nuk do të ketë rrënim gjatë natës, ndërsa pjesa më e madhe e tunelit është larg fshatrave. Do të bëhet mbikqyrja e lokacioneve kyçe dhe do të ndërmerren aktivitete për zvogëlimin e zhurmës poqese niveli i zhurmës është mbi të lejuarën, posaçërisht nëse ka ankesa.

Gjatë punës, burimi i vetëm kryesor i zhurmës do të jenë turbinat në ndërtesën makinerike, me shumë pak zhurmë elektrike në nënstacionin e ri dhe linjën përçuese. Zhurma e turbinave nuk duhet të jetë e dëgjueshme më larg nga ndërtesa makinerike, ndërsa askush nuk jeton në afërsi.

Rezime e masave për zbutje: ndërtim gjatë ditës, përveç depërtimit në tunel, rrënim vetëm gjatë ditës, mbikqyrje dhe nëse është e nevojshme ndryshimi në praktikë; plani për menaxhimin me rrënimin, lajmërimi i popullatës për aktivitetet më të mëdha ndërtimore dhe për rrënim.

d. Ndikimet potenciale në cilësinë e ujit

Duke pasur parasysh se ndërtimtaria do të zhvillohet në ose në afërsi të ujit, mund të ketë ndikim mbi cilësinë e ujit sipërfaqësor nëse nuk zbatohen kontrole adekuate. Nëse do të kishte ndikime mbi cilësinë e ujit, ato do të mund t'i rrezikonin peshqit dhe organizmat e tjerë ujëorë, ndërsa do të mund të dëmtonin edhe vendbanimin ujëorë. Ndikimet potenciale dhe mënyrëat në të cilat ato mund të shmangen, përfshijnë:

- *Derdhjet e paqëllimshme të karburanteve ose vajrave nga automjetet dhe pajisjet, të cilat punojnë në ose afërsi të ujit. Automjetet dhe pajisjet duhet të mirëmbahen dhe kontrollohen, do të kenë edhe pajisje për pastrim gjatë rrjedhjes; shoferët dhe operatorët do të jenë të trajnuar.*
- *Erozioni i materialit të fortë (lym, baltë, thëngjill) në ujë:*
 - Kur punët ndërtimore kryhen pranë shtretërve të lumëenjtve ose në to (në lokacionin e pendës, në lokacionet e ndërhyrjes, në lokacionet e ndërtimit të urave, dhe në lokacionin e lëshimit në ndërtesën makinerike).
 - Erozioni i materialit të fortë në ujë me rrjedhje atmosferike nga sipërfaqet, të cilat pastrohen nga vegetacioni ose në mënyrë tjetër zhvishen.

Plani i kontrollit të erozionit do të kërkojë zbatimin e praktikave më të mira internacionale për ndalimin e erozionit. Lumëenjt do të mbikqyren për çdo ditë (për ujin me ngjyrë dhe të turbullt, p.sh), ndërsa praktikë e punës do të ndryshohen sipas nevojave me qëllim që të ndalohet ndikimi në cilësinë e ujit. Përveç kësaj, do të kryhen analizat laboratorike javore të mostrave nga uji që të vërtetohet harmonizimi me standardet për ujë.

- *Lëshimi i ujërave sanitare (kanalizimi) nga lokacionet dhe nga kampi ndërtimor. Do të përdoren tualete mobile ose metoda tjera të miratuara të menaxhimit (p.sh miratimi i sistemit septik).*
- *Lëshimi i materialit të fortë në ujërat e ndotura nga depërtimi i tunelit dhe nga makinat për përzierjen e betonit. Nëse duhet të lëshohet uji, duhet të trajtohet sipas nevojave, që të jetë në pajtueshmëri me vlerat kufitare të Maqedonisë për lëshim.*

Në përgjithësi, ndikimi nga ndërtimi mbi cilësinë e ujit do të jetë i vogël dhe i përkohshëm edhe pse mund të paraqiten incidente afatshkurtëra me një ndikim më qelqtaioz.

Gjatë punës, ndikimet potenciale do të jenë me një kërcënim shumë më të vogël dhe mund të kontrollohen, kështu që do të jenë të parëndësishme. Ndikimet potenciale dhe zbutja e tyre përfshijnë:

- Kalbja e vegjetacionit në akumulimin e rimbushur mund të çojë në nivele të ulta të oksigjenit në ujë. Siç u përmend më sipër, plani për pastrimin e vegjetacionit do të sigurojë sa më shumë që të jetë e mundur mënjanim të të vegjetacionit, kështu që kjo nuk do të duhej të jetë problem. Madje edhe në këtë rast, do të bëhet mbikqyrja e ujit për oksigjenin e tretur dhe do të ndërmerren masa për pasurimin e ujit me oksigjen, nëse është e nevojshme.
- Marrja e ujit nga akumulimi pesë orë në ditë do ta zvogëlojë nivelin e akumulimit për rreth 5 metra. Derisa akumulimi nuk plotësohet përsëri gjatë natës, do të ketë një shirit të ngushtë në tokë të zhveshur në "bregdetin", ku ndoshta nuk do të mund rritet vegjetacioni. Mund të paraqitet një erozion i caktuar nga kjo linjë e ngushtë prej rrjedhave atmosferike dhe eventualisht nga veprimi i valëve. Ajo nuk duhej të jetë e konsiderueshme. Nëse vërehet erozioni, sipërfaqja do të stabilizohet me gurë ose disa mjete të tjera për të parandaluar erozionin.
- Rrjedha ose çarjet në sifon do të mund të çojnë deri te erozioni i lokalizuar derisa sa të mbyllet ndërhyrja. Nuk pritet që kjo të ndodhë, por nëse ndodhë nuk do të shkaktoje ndonjë problem më të madh.
- Mënjanimi dhe Lëshimi i sedimenteve nga shtresimet (basene për shtresim) pranë ndërhyrjeve dhe nga akumulimi do të mund të shkaktojë turbiditet (turbullim) në ujërrat sipërfaqësore, nëse nuk kontrollohet me kujëdes. Rrjedhja e sedimentit nga akumulimi mund të ndodhë vetëm gjatë rrjedhave të larta në lumë, e cila do të ketë tash më turbiditet të lartë dhe sipas kësaj nuk do të ketë ndikim të madh. Sedimenti do të hiqet nga pjesët me sediment në afërsi të ndërhyrjeve do të menaxhohet vetëm në mënyrë që do të lejohet nga organet kompetente, kurrë nuk do të lëshohet në lumëenjtë.

Në përgjithësi, puna e HEC "Boshkov Most" nuk do të ketë ndikim të konsiderueshëm në cilësinë e ujit.

Rezime e masave për zbutje: Planin për kontrollin e erozionit do ta parashikojë përdorimin e praktikave më të mira ndërkombëtare. Planin për pastrimin e vegjetacionit do ta parandalojë kalbjen e vegjetacionit në ujë. Me mbikqyrje do të mundësohet që të identifikohen problemet eventuale dhe të njejtat shpejt të eliminohen. Mbeturinat sanitare do të menaxhohen në mënyrë që nuk do të ketë mënjanim, i cili do të jetë në kundërshtim me standardet e Maqedonisë. Me sedimentet do të menaxhohet vetëm në mënyrë që do të lejohet nga organet kompetente, ndërsa rrjedhja e sedimenteve do të paraqitet vetëm gjatë periudhave të rrjedhave të larta në lumë.

e. Ndikimet potenciale të rrjedhave të ujërave nëntokësore dhe ujërave të cekta sipërfaqësore

Pjesa më e madhe e ujit në lumin Malla Reka dhe rrjedhat e tyre do të bartet përmes tunelit deri te ndërtesa makinerike. Në këtë do të zvogëlohet sasia e ujit që rrjedh në lumëejt. Ky

zvogëlim i rrjedhave do ta zvogëlojë vendbanimin ujëorë dhe mund të vijë deri te dëmtimi i popullatës së peshqive dhe organizmave tjerë që jetojnë në ujëë. Siç përshkruhet në pjesën (i) më poshtë, projekti të paktën do të mbajë „rrjedha të minimumit biologjik“ në të gjitha lumëenjtë dhe me këtë duhet të pengohen ndikimet e rëndësishme ndaj biodiversitetit.

Përveç kësaj, zvogëlimet e sasisë së ujit në lumëenjtë do të mund të ndikojë në ujëërat e cekta nëntokësore në disa lokacione, duke përfshirë:

- Gjatë ndërtimit, nivelet e ulura të ujëërave nëntokësore të lidhura me thatësitat dhe nxjerrjen e ujërave nëntokësore gjatë ndërtimit të pendës. Nëse ndodh kjo, kjo do të ishte përkohësisht, duke pasur para sysh se thatësira do të përfundojë atherë kur do të përfundohet penda, ndërsa do të ndikojë vetëm në sipërfaqe të kufizuar sepse klisura është shumë e ngushtë
- Gjatë punës, masat e zvogëluara të ujëërave nëntokësore në shtetërit e lumëenjëve nëpërujëë nga penda dhe ndrhyrja. Kjo nuk duhet të shkaktojë probleme të rëndësishme, përveç pranë një lëvizje të lumit Garskë, i cili është përshkruar në pjesën (g).
- Gjatë ndërtimit, kontaminimi i ujëërave nëntokësore nga ngjarjet e njëjta të përshkruara për ujëërat sipërfaqësore në pjesën (f) më lart (rrjedhje pa qëllim dhe претекувања, shkarkimi i ujëërave të ndotura sanitare, etj.). Kjo do të parandalohet në mënyrëën e përshkruar më sipër.

Rezime e masave për zbutje: Zbutja: lëshimi i „rrjedhave minimale biologjike“ dhe monitorim i kontinuar i rrjedhave, monitorim i ujëërave të cekta nëntokësore të lumit Garskë.

f. Gjeologjia

Nuk do të ketë ndikime të rëndësishme të gjeologjisë në korniza lokale ose rajonale gjatë ndërtimit të punës.

Rezime e masave për zbutje: Nuk nevojiten aktivitete të veçanta përveç atyre që janë parashikuar më herët.

g. Toka

Toka mund të rrezikohet në dy mënyrë kryesore: humbjes së shtresës së sipërme të tokës për shkak të pastrimit të sipërfaqes për rrugët dhe puntorit tjera dhe kontaminimi nga rrjedhat e paqëllimshme. Shtresa sipërfaqësore e tokës do të ripërtihet kur sipërfaqja do të gërmohet dhe skladohet deri sa nuk është e nevojshme për revitalizimin më vonë. Ndikime të rëndësishme për shkak të kontaminimit do të shmangen si në mënyrën që është e përshkruar në pjesën (b) më sipër.

Rezime e masave për zbutje: programi për mbrojtjen e menaxhimit me shtresën sipërfaqësore të tokës, pajisje për rrjedhën në të gjitha automjetet dhe pajisjet, trajnime për të gjithë shiferët dhe operatorët, plani për reaktion gjatë rrjedhave.

h. Erozioni

Erozioni i tokës mund të shkaktojë përqendrim të larta të materive suspenduese të ngurta (papastërtia, balta, argjili) në ujërat sipërfaqësore, ndërsa kjo mund ta rrezikojë vendbanimin ujëorë dhe ta zvogëlojë sasinë e dritës që hynë në ujë. Të dy fenomenet mund të kenë efekt negati ndaj peshqive dhe organizmave tjerë ujëorë.

Luhatja e përditshme e nivelit të ujit dhe veprimtaria e valëve në skajin e akumulimit mund të shkaktojë erozion të caktuar të tokës, posaçërisht derisa nivelet e ujit në akumulim janë të ulta, ndërsa brigjet pa vegjetacion janë ekspozuar. Por, erozioni më i vogël eventuaal nga brigjet rreth skajit të akumulimit me ujë do të jetë e parëndësishme në krahasim me sasinë e sedimentit që do të sillet në hapësirën për skladim përmes gjendjeve të vërshimeve të mëdha. Nuk pritet erozion i kanalit lëshues të ndërtesës makinerike, duke pasur para sysh se gjatësia e vogël e lumit të mbrohet me kanalin e betonit.

Në përgjithësi, erozioni do të mund të shkaktojë efekte të rëndësishme në cilësinë e ujit, nëse nuk kontrollohet. Ndjekja e planit për kontrollin e erozionit do të sigurojë që të zbatohen praktikatat më të mira ndërkombëtare, ndërsa me këtë do të parandalohen ndikimet e rëndësishme, eventualisht nga incidentet kohore afatshkurtëra. Programi për monitorim me të cilin parashihet që të mblidhen shembuj të paktën një herë në javë do të sigurohet plotësimi i standardeve për cilësinë e ujit. Përveç kësaj, të gjitha lumëenjtë përmes ujit nga ndërtimtaritë do të mbikqyren çdo ditë dhe nëse tregohet se uji është i turbullt ose në ndonjë mënyrë tjetër i rrezikuar, do të zbatohet plan i akcioneve për zbulimin dhe mënjanimin e shkakut.

Rezime e masave për zbutje: plani për kontrollin e erozionit, riparimin dhe stabilizimin nëse paraqitet erozioni, marrjave e mostrave dhe analiza njëherë në javë, mbikqyrje të përditshme.

i. Biodiverziteti

Biodiverziteti siç është përshkruar më lartë, pjesa më e madhe e projektit bie në kufijt e parkut nacional “Mavrovë”, që është propozuar për rrjetin Emerald dhe do të kandidohet si lokalitet për Naturën 2000. Rajoni është i pasur me biodiversitetin bimorë dhe ate shtazorë.

Bimët . Në sferën e projektit pjesa më e madhe është e pyllëzuar (rreth 70% të sipërfaqeve që do të ndërhyjnë janë pyjet) dhe haset një numër i rallë i llojeve bimorë, duke përfshirë kalin e gështenjës (*Aesculus hippocastanum*), shkozë e zezë, qarr , frashër i zi, ramondia, astragalus, carex dhe lloje tjera. Një sferë e rëndësishme shtrihet në gjatësin e lumit Garskë, ku prej 50-80 drunjë të lashtë të gështenjës rriten rreth 2 deri në 3 kilometra pranë lumit. Kjo është vetëm njëra prej katër pyjeve të këtilla relikte të gështenjave-shkozave në ballkan (gjegjësisht pyje që janë mbetje prej pyjeve të dikurshme të gjerësisht të).

Gështenjat kërkojnë që rrënjët e tyre të jenë në kontakt me lagështin e ujërave të cekëta nëntokësore , ndërsa zvogëlimi i nivelit të projektit të ujit në lumëenjt mund të shkaktojë lëshim në nivelin e ujërave të thella nëntokësore. Përveç kësaj të gjitha lumëejt mbështesin një shkallë të caktuar të vegjetacionit të bregut të lumit, i cili gjatë kohës do të jetë i rrezikuar nga sasia e zvogëluar e ujit në lumëejt, kryesisht, ka mundësi që brigjet e rajoneve të lumëenjve të zvogëlohen me kohën dhe të zëvendësohen me vegjetacionit kodrinorë.

Gjatë fazës së punës, përbërja dhe përfshirja e disa bimëve me të cilat ushqehemi p.sh çaji i gjelbërt, kerpurdhat etj) dhe llojet e luleve si rezultat i menaxhimit të pritur dhe arritshmëria e rajonit duke pasur para sysh ate se do të rritet numri i vizitorëve në rajonin në të cilin do ti mbledhin. Kjo nuk duhet të jetë e rëndësishme.

Do të ndërmeren disa aktivitete që të zvogëlohen ndikimet e bimëve:

- Do të prgatitet plan për menaxhimin me pastrimin e vegjetacionit dhe i njeiti do të revidohet nga drejtorja e Parku dhe me te do të përcaktohet kur dhe ku mund të priten drunjët dhe bimët tjera. Me të, gjithashtu do të kërkohet që të pritet më shumë vegjetacion sesa është absolutikisht e domozdoshme, posaçërisht në sferat e skajeve të lumëenjve.
- Me programin për monitorim do të ndiqet gjendja e drunjëve të gështenjës së zgjedhur dhe niveli i ujërave nëntokësore të cekëta, të paktën në vitet e para të punës. Nëse uji nëntokësorë bëhet më i thellë dhe kjo ka ndikim në drurët e gështenjës, mund të ketë nevojë që të rriten rrjedhat e minimeve biologjike në lumin Garskë (shih më poshtë) ose të ndërmerren aktivitete tjera që të rritet niveli i ujërave nëntokësore.
- Rajonet të cilat nuk do të jenë të nevojshme për ndërtimin ose punën, do të mbjellen me lloje autoktone.

Sisorët e mëdhenjë. Rajoni e përdorë luqerbullin dhe sisorët e mëdhenjë si plaçkë të saja dhe këto mund të jenë të shqetësuar ose prekura në një mënyrë tjetër. Zhurma dhe shqetësimi gjatë fazës së ndërtimit do të mund të shkaktojë ndryshim në modelet e qarkullimit të disave kafshëve të rëndësishme, të cilat do të mund që të enden anembanë pjesët e ndryshme të

sferës së projektit. Mënjanimi i disa pjesëve të bashkësive pyjore, posaçërisht në sferat e rafshta, do të mund që të ndikojë edhe në disa lloje shtazore. Do të zbatohen disa aktivitete që të kontrollohet rëndësia e ndikimit. Zhurma dhe shqetësimi, në pjesën më të madhe, do të paraqiten brenda ditës kur pjesa më e madhe e kafshëve të rëndësishme janë aktive. Shqetësimi në rajonet që janë më largë nga ndërtimtaritë e drejtpërdrejta do të mbahen në minimum, me çka do të zvogëlohet rajoni në ndikim.

Sisorët e imët. Sisorët e imët (përparësi kanë brejtësit) të cilët jetojnë në rajonin e projektit janë relativisht të lëvizshëm. Edhe pse do të ketë një shkallë të caktuar të humbjes së vendbanimeve që mund të ndikojnë në bashkësit lokale, nuk duhet të ketë ndikim ndaj popullatës së llojeve. Ndryshimet e vogla në popullatën e sisorëve të imëta nuk duhet të kenë ndikim të rëndësishëm në sinxhirin e ushqimit për egërsirat e mëdha.

Rajoni i pellgut të lumit Radikë dhe lumit Malla Reka si pjesë e të njejtës siguron vendbanim potencial për lundërat. Rrejdha e zvogëluar do të mund ta zvogëlojnë vëllimin e vendbanimit të tyre. Qëndrueshmëria e rrjedhës së ujit, zbatimi i plotë i Planit për menaxhim me pastrimin e vegjetacionit, biomotorimin para fillimit të ndërtimit dhe i kontinuarë (5 vite) biomotorim do të jetë baza për mbrojtjen eventuale shtesë të vendbanimeve.

Organizmat ujëore dhe gjysëm-ujëore (ujëorët, insektet). Zvogëlimi i rrjedhave dhe si rezultat i kësaj zvogëlimi i sferës pranë lumit do ta zvogëlojë vendbanimin e ujëorëve. Edhe pse mund të ketë ndikim në popullatat lokale, nuk ekzistojnë lloje të njohura endemike të cilat mund të gjinden vetëm këtu, kështu që është dashur të paraqiten ndikime të kufizuara të popullatës të cilës do lloji. Përgatitja e programit për monitorim në të gjitha stinët do të mundësojë zhvillimin e masave për zbutje, nëse ato janë të nevojshme të mbrohen ujëorët ose llojet tjera të ujëorëve.

Aktivitetet ndërtimore në lumin do të kontribuojnë për zvogëlimin e vendbanimeve për insektet, përbërjen dhe strukturën e bashkësive që varen prej insekteve. Banorë tipik të lumenjëve të shpejta, ftohta dhe lumenjëve të larta malore të aerizuara do të jenë të rrezikuara në ndërtimtarit në të cilat punohet në lumë, ndërsa edhe në bimët e vogla nëpër ujë. Me këtë do të mund të zvogëlohen popullatat lokale të insekteve nga aradhat e Ephemeroptera, Trichoptera и Pleoptera dhe llojeve tjera. Në mënyrë të njejtë, zvogëlimi i rrjedhave do të ndikojë në popullatën e insekteve të të gjitha rrjedhave prej të cilave merret uji. Përsëri, me këtë do të rrezikohen popullatat lokale, por nuk do të ketë efekt të rëndësishëm në llojet e popullatave. Përveç kësaj, qëndrueshmëria e minimumit biologjik minimal (shih më poshtë) do të sigurojë ekosistem që të mos jetë në mënyrë të rëndësishme e rrezikuar.

Zogjtë. Në rajonin e projektit dhe rrethin e tij mund të gjinden rreth 77 lloje të zogjëve, edhe pse në rajonin e drejtpërdrejtë ose në rrjonet më të afërta nuk ekzistojnë strehime më të rëndësishme për zogjtë. Aktivitetet ndërtimore do të shkaktojnë shqetësime të përkohshme (deri në 3-4 vite), të cilat mund ti detyrojnë zogjtë që ta braktisin rajonin në stinën e folesë, ndërsa pastrimi i vegjetacionit mund të mënjanojë një pjesë të vendbanimit të tyre.

Peshqit. Gjatë stinës ndërtimore, trofta e përrrenjëve do të gjindet në rrjedhat poshtme të lumit Malla Reka dhe lumit të Radikës, ndërsa jo nëpër rrjedhat e sipërme të ujit. Shumëimi bëhet në vjeshtën e vonshme dhe fillimin e dimrit, kështu që ndërtimi nuk do të ketë ndikim në shumëimin. Ndërtimi i lumit do të mënjanojë disa prej degëve të lumit për përdorimin nga trofta e përrrenjëve dhe llojeve tjera të peshqive. Në shumëicën e lumënjëve, ndërtimi duhet që të kryhet vetëm në njëren pjesë të stinës, me çka në një masë të madhe do të zvogëlohen ndikimet potenciale. Në disa lokacione, duke e përfshirë pendën, akumulimin dhe kanalin lëshues të ndërtesës makinerike, ndërtimi do të zgjasë më shumë se një stinë ndërtimore. Këtu ndërtimi do të mund të ketë një efekt më të rëndësishëm i cili do të mund ti rrezikojë popullatat lokale

Turbiniteti i rritur i ujit (për shkak të aktiviteteve ndërtimore), gjithashtu do të ketë ndikime negative të popullatave më të reja të troftës së përroit. Kjo popullatë do të migrojë në rrjedhat më të mëdha (të lumit Garskë ose lumit Malla Reka) dhe do të jetë një ushqim potencial për popullatën e peshqive më të mëdhenjë të troftës së përruas.

Vetë penda do të krijojë barierë për qarkullimin e peshqive në rrjedhën e poshtme dhe rrjedhën e sipërme. Me këtë do të izolohen popullatat e peshqëve, duke përfshirë edhe troftën e përroit, rrjedhën e sipërme nga penda, që do të ketë efekte negative në popullatat e ardhshme. Do të kryhet monitorim i peshqive nga rrjedhat e sipërme të pendës dhe nëse është e nevojshme do të përgatitet program për ripeshkim që të mundësohet brezi i ri i peshqëve nga pjesët e rrjedhave të poshtme të pendës që të barten mbi pendë me qëllim që mbahet llojllojshmëria gjenetike.

